



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:081237
Datë: 15.01.2025
Numri i dokumentit: 06714326

Pml.nr.753/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Rasim Rasimi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarve: B. G., nga L. dhe A. S., nga Gj., për shkak të veprës penale “Vjedhja”, e parashikuar në nenin 313, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të dënuarit B. G., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.294/2023, datë 22.03.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.905/2024, datë 27.08.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 14.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtëses së të dënuarit B. G., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.294/2023, datë 22.03.2024 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.905/2024, datë 27.08.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.294/2023, datë 22.03.2024, të dënuarit: B. G. dhe A. S., i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale “Vjedhja”, nga neni 313, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa për shkak të kryerjes së kësaj vepre penale, ndaj secilit prej tyre ka shqiptuar dënim me burgim prej nga dy (2) vjet dhe dënim me gjobë në shumë prej nga dymijë (2,000) euro, për secilin prej tyre veç e veç, të cilat dënime do t’i paguajnë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pasi që ky

aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Nëse të dënuarit nuk dëshirojnë, nuk mundën ose nuk janë në gjendje të paguajnë dënimin me gjobë, atëherë dënimi me gjobë do t'ju zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo njëzet (20) euro të dënimit me gjobë do të caktohet nga një (1) ditë burgim. Të dënuarit B. G., koha e kaluar në paraburgimit nga data 04.04.2023 e deri më 20.10.2023, kurse të dënuarit A. S., koha e kaluar në paraburgim nga data 03.04.2023 e deri më 30.04.2023, do t'ju llogaritet në dënimet me burgim të shqiptuara. I dëmtuari N. D., nga ..., rr."...", për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil. Janë detyruar të dënuarit që secili veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga pesëdhjetë (50) euro dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej nga njëzet (20) euro, të gjitha këto brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.905/2024, datë 27.08.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të dënuarve: B. G., dhe A. S., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësja e të dënuarit B. G., avokatja Kaqusha Avdiu Sylejmani, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen, ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza apo të anulohen këto aktgjykime dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Kryeprokurori i Shtetit, me parashtresën KMLP.nr.423/2024, datë 16.12.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtëses së të dënuarit B. G.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa është e pabazuar.

Mbrojtësja e të dënuarit B. G., në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, në radhë të parë për faktin se në këto aktgjykime nuk janë paraqitur arsye të mjaftueshme në lidhje me faktet vendimtare, pretendimet e mbrojtjes dhe provat kundërthënëse. Në dispozitivin e aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë nuk janë përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat lidhur me mënyrën e kryerjes së veprës penale, veprimet inkriminuese të të dënuarit B. G., përkatësisht nuk ceket fare ora e markës "...", e cila është gjetur në shtëpinë e të dënuarit në fjalë dhe është konfirmuar nga ana e të dëmtuarit se i përket kunatës së tij. Provat e siguruara nga prokuroria nuk janë nxjerrë në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të KPP-së, andaj edhe si të tilla janë prova të papranueshme, kështu që

mbi këto prova nuk mund të vërtetohet fajësia e të dënuarit. Në këtë drejtim, mbrojtja i referohet gjetjes së orës “...” në shtëpinë e të dënuarit B. G., dhe identifikimit të saj nga ana e kumatës së të dëmtuarit N. D., pasi që kjo është provë e papranueshme, ngase konfiskimi i orës është bërë në kundërshtim me nenin 106, paragrafi 9 të KPP-së, sepse mungon procesverbali i konfiskimit të kësaj ore dhe të dhënat tjera të rëndësishme në këtë drejtim, si dhe kontestohet edhe mënyra e identifikimit të orës nga ana e kumatës së të dëmtuarit. Shkelje tjetër esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas mbrojtjes ka të bëjë me nenin 119, paragrafi 5 të KPP-së, duke pretenduar se aktgjykimi nuk mund të mbështetet në deklaratat e të bashkëpandehurit A. S., të dhëna në procedurë paraprake, si provë e vetme fajësuese, për të shpallur fajtor dhe dënuar të dënuarin B. G., duke qenë se i dënuari A. G., në deklaratën e dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se ka qenë me një person tjetër dhe jo me B. G. Gjithashtu, pretendohet se edhe vlerësimi dhe analizimi i provave tjera nuk është bërë në mënyrën e duhur, duke ju referuar edhe deklarimeve të dëshmitarit I. V., nga deklaratimet e të cilit nuk mund të vërtetohet se të dënuarit janë personat që kanë hyrë në shtëpinë e të dëmtuarit, si dhe janë shkelur edhe të drejtat e mbrojtjes, në kuptim të refuzimit të propozimit të për të dëgjuar si dëshmitare motrën e të dënuarit B. G. Në fund, mbrojtja i konteston edhe dënimet e shqiptuara, duke konsideruar se ndaj të dënuarit është shqiptuar dënim i rëndë me burgim, në raport me veprimet inkriminuese të të dënuarit, peshës së veprës penale, sanksionit penal të paraparë, bashkëpunimit vullnetar të tij me policinë dhe gjykatën, dëmit pasuror të shkaktuar ndaj palës së dëmtuar, rrezikshmërisë shoqërore, të kaluarës së tij kriminale dhe rrethanave tjera.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shikoi shkresat e lëndës dhe analizoi pretendimet e lartcekura, konstatoi se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as me ndonjë shkelje tjetër të dispozitave të procedurës penale të cilat do të ndikonin në ligjshmërinë dhe drejtshmërinë e këtyre aktgjykimeve, siç nuk janë të përfshira as me shkelje të ligjit penal.

Fillimisht, duhet theksuar se në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është paraqitur vepra penale për të cilën janë shpallur fajtor të dënuarit: B. G. dhe A. S., së bashku me të gjitha faktet e rëndësishme, mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe rrethanat e nevojshme që e përbëjnë figurën e veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor të njëjtit, si dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal, ashtu siç parashihet në nenin 369, paragrafi 4 lidhur me nenin 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së, ndërsa fakti që në këtë pjesë nuk përcaktuar specifikuar ora “...” është i parëndësishëm. Kjo për faktin se në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë janë konstatuar sendet që janë vjedhur nga ana e të dënuarve: B. G. dhe A. S., duke përfshirë këtu “...para të metalta në vlerë prej njëmijë (1,000) euro, të cilat ishin nga një (1) dhe dy (2) euro, si dhe orë dore, bizhuteri, parfume të ndryshme, ashtu që me tu hetuar nga i dëmtuari, nga ballkoni i katit të dytë kërcejnë në tokë dhe largohen nga vendi i ngjarjes...”, ndërsa ora “...” e cila është gjetur në shtëpinë e të dënuarit B. G., është identifikuar nga kunata e të dëmtuarit si send që është vjedhur në shtëpinë e të dëmtuarit. Në këtë mënyrë,

fakti që në dispozitiv të aktgjykimit nuk është specifikuar ora e lartcekur, nuk e bënë të pakuptueshëm dispozitivin, pasi që është vërtetuar dhe është e qartë se bëhet fjalë për këtë orë, pavarësisht që nuk është theksuar ora e dorës "...", ngase ora e njëjtë që është vjedhur në shtëpinë e të dëmtuarit është gjetur në shtëpinë e të dënuarit B. G., nga ana e zyrtarëve të policorë të cilit kanë qenë duke e zbatuar urdhër kontrollin e gjyqtarit të procedurës paraprake.

Në anën tjetër, përmes aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton se gjykata në fjalë ka përmbushur edhe detyrimet e saj për të paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta sa i përket të gjitha pikave të rëndësishme, referuar nenit 369, paragrafëve 6, 7 dhe 8 të KPP-së. Në këtë drejtim, nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë shihet që janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh janë konsideruar të vërtetuara, si dhe janë paraqitur arsyet në të cilat, gjykata në fjalë është bazuar me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të dënuarve në drejtim të kryerjes së kësaj vepre penale, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal, duke e rikualifikuar veprën penale. Po ashtu, në arsyetimin e këtij aktgjykimi shihet që janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe të qarta edhe sa i përket rrethanave që gjykata në fjalë ka marrë për bazë e rastin e caktimit të dënimeve.

Gjithashtu, edhe provat e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë i ka analizuar dhe vlerësuar në mënyrën e duhur, ashtu siç është parashikuar në nenin 360, paragrafi 2 të KPP-së, ku nga arsyetimi i aktgjykimit në fjalë rezulton se të gjitha provat janë vlerësuar një nga një dhe më pas në lidhje me provat tjera, ndërsa më pastaj janë nxjerrë përfundimet e caktuara në lidhje me vërtetimin e fakteve përkatëse. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë një lidhshmëri logjike dhe kohore në mes vete, si dhe janë në harmoni me deklaratimet e dëshmitarëve dhe provat tjera materiale, duke përfshirë këtu edhe video-incizimet e kamerave të sigurisë. Përveç deklaratimeve të dëshmitarëve: N. D. dhe I. V., të cilët e përshkruar ngjarjen ditën kritike, edhe dëshmitari A. D., si zyrtar policor kishte sqaruar të gjitha veprimet hetimore që i kishin ndërmarrë deri në identifikimin e kryesve të kësaj vepre penale e që nëpërmjet video-incizimeve të marra nga vendi i ngjarjes kanë identifikuar veturën e markës "Reno", me ngjyrë të kuqe, e cila ka rezultuar se ishte e të dënuarit A. S., i cili pas intervistës kishte konfirmuar se kishte qenë me të dënuarin B. G., e që pas kësaj informate, zyrtarët policor kanë shkuar në kontroll në shtëpinë e të dënuarit B. G. dhe gjatë kontrollit në shtëpinë e të njëjtit, ndër të tjera kanë gjetur edhe orën e dorës "F.", e cila ishte një prej sendeve të vjedhura në shtëpinë e të dëmtuarit. Kjo orë e dorës është identifikuar nga kunata e të dëmtuarit e cila ishte pronare e saj, fakt i cili është vërtetuar edhe nga fotot që gjenden në shkresa të lëndës dhe në procesverbalin e kontrollit të shtëpisë së të dënuarit. Gjithashtu, dëshmitari në fjalë kishte theksuar se në video-incizim shihet vetura e markës "Reno" me ngjyrë të kuqe, për të cilën i dënuari A. kishte konfirmuar se është e tij dhe se i njëjti ishte kur ka hypur në veturë se bashku me të dënuarin B. G. dhe se kjo video ishte pas kryerjes së vjedhjes në shtëpinë e të dëmtuarit N. D.

Edhe pretendimet e mbrojtjes në lidhje me provat e papranueshme, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës janë të pabazuara, pasi që të gjitha provat mbi bazën e të cilave janë bazuar aktgjykimet e kundërshtuara janë prova që janë siguruar në mënyrë të ligjshme dhe nuk rezultojnë se të njëjtat janë të papranueshme. Në këtë drejtim, nga shkresat e lëndës shihet se kontrolli i shtëpisë së të dënuarit B. G., ishte bërë në bazë të urdhër kontrollit të gjyqtarit të procedurës paraprake me shenjë UGJK.nr.31/2023, datë 03.04.2023, ndërsa gjatë kontrollit është përpiluar procesverbal i posaçëm në të cilin janë përshkruar të gjitha veprimet e ndërmarra, personat prezentë, si dhe sendet që janë gjetur në shtëpinë e të dënuarit në fjalë, ku në mesin e sendeve të gjetura figuron edhe ora e dorës "F." dhe të gjitha këto sende janë fotografuar, ku fotot gjenden në shkresa të lëndës. Ndërsa, pas sekuestrimit të sendeve, ka vazhduar procedura e identifikimit, ku kunata e të dëmtuarit N. D., e kishte identifikuar orën e saj të dorës të markës "F.", me numër serik F...., e cila ishte vjedhur në shtëpinë e të dëmtuarit, e cila orë më pastaj, është kthyer, gjë që vërtetohet edhe nga vërtetimi mbi kthimin e sendeve. Përveç kësaj, gjykatat e instancave më të ulëta kanë arsyetuar se fajësia e të dënuarit B.G., nuk është bazuar vetëm në deklaratimet e të dënuarit A. S., pasi që janë edhe një sërë provash tjera mbi bazën e të cilave është vërtetuar një aspekt i tillë, të theksuara edhe më lart.

Sa i përket pretendimeve të mbrojtjes në lidhje me administrimin e provave tjera, përkatësisht dëgjimin si dëshmitare të motrës së të dënuarit B. G., Gjykata Supreme e Kosovës rikujton se "jo çdo propozim i palëve për administrimin e provave të caktuara duhet të detyrimisht që të aprovohet nga gjykata".

Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se është nën autoritetin e gjykatave që të vlerësojnë në çdo rast konkret, nëse duhet aprovuar apo jo propozimet e tilla, duke i pasur parasysh natyrën e çështjes dhe specifikat e saj, rëndësinë e provës, si dhe fakteve që pretendohet të vërtetohen përmes provës së propozuar, në kontekstin e rrethanave të rastit. Përndryshe, në nenin 252, paragrafi 2 të KPP-së janë parashikuar situatat kur gjykata mund të mos e aprovon propozimin e palëve për administrimin e provave të caktuara, ndërsa në rastin konkret nuk është paraqitur asnjë rrethanë apo indikacion konkret dhe i besueshëm që do arsyetonte një propozim të tillë.

Përveç aktgjykimet të gjykatës së shkallës së parë, edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe në asnjë mënyrë nuk rezultojnë që të jetë në kundërtënie në mes vete apo me provat që gjenden në shkresa të lëndës, andaj, edhe si i tillë është hartuar konform standardeve që parashihen me dispozitat përkatëse ligjore, ndërsa konkludimet e arritura janë të pranueshme edhe për Gjykatën Supreme të Kosovës, pasi që gjejnë mbështetje, si në provat e administruara, ashtu edhe në dispozitat ligjore të aplikueshme. Nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë del që gjykata në fjalë ka trajtuar mjaftueshëm edhe ankesat e mbrojtësve të të dënuarve: B. G., dhe A. S., duke i vlerësuar pretendimet ankimore dhe duke paraqitur arsye se pse këto pretendime ankimore janë të pabazuara.

Sa i përket çështjes së shqiptimit të dënimeve të rënda, Gjykata Supreme e Kosovës rikujton se sipas dispozitës së nenit 385, paragrafi 5 të KPP-së, kur është fjala për vendimin për

dënimin, shkelje e ligjit penal konsiderohen vetëm rastet kur në marrjen e vendimit për dënimin, gjykata ka tejkeluar kompetencat ligjore. Pra, me fjalë të tjera, sipas kësaj dispozite ligjore, tejkalimi i kompetencave ligjore nga ana e gjykatës me rastin e vendosjes lidhur me dënimin, konsiderohet si shkelje e ligjit penal. Ndërsa, në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar rrethanat përkatëse relevante, të dënuarit B. G., i ka shqiptuar dënimet përkatëse me burgim dhe me gjobë, brenda kufijve të parashikuara me ligj për veprën penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, çka do të thotë se nuk janë tejkeluar kompetencat ligjore.

Përndryshe, edhe në këtë çështje penale, Gjykata Supreme e Kosovës rithekson se matja e dënimeve dhe vlerësimi i rrethanave përkatëse relevante është në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, varësisht nga rrethanat e rastit, ndërsa duke u bazuar në nenin 432, paragrafi 1 të KPP-së, këto pretendime në lidhje me shqiptimin e dënimeve më të buta, nuk mund të jetë arsye për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Gjithashtu, duhet theksuar se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtëses së të dënuarit B. G., përmban edhe pretendime të caktuara që ndërlidhen me gjendjen faktike, duke ju referuar nenit 386, paragrafët 1-3 të KPP-së, mirëpo Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se konform nenit 432, paragrafi 2 të KPP-së, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike.

Andaj, edhe nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pabazuar dhe pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.753/2024, më 14.01.2025

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Valdete Daka